



ADMINISTRATA TATIMORE e KOSOVËS (ATK-ë) – Divizioni i Ankesave (DA-ve)-respektivisht zyrtari i ngarkuar me rastin Ramadan Ahmeti, duke vendosur në çështjen administrative tatimore, sipas ankesës së subjektit tatimor [redacted], me numër të regjistrimit fiskal [redacted] me seli në Rr: Rashidi Ali Agës-Pejë, e dorëzuar në Administratën Tatimore të Kosovës –Divizioni i Ankesave me datë 18.11.2022 e protokolluar me Nr:483/2022, kundër kërkesës për faljen e ndëshkimeve nga ATK-DMB-së (Departamenti Mbledhjes së Borxheve), në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr:03/L-222 Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, mori këtë:

#### VENDIM

I. Hedhet si e pa lejueshme ankesa me nr.483/2022, e datës 18.11.2021, e subjektit tatimor, [redacted], me numër të regjistrimit fiskal [redacted] me seli në Rr: Rashidi Ali Agës-Pejë, në mbështetje të nenit 129, paragrafi I, nën paragrafi 1.4, i Ligjit Nr. 05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe nenit 44, paragrafi 15, i UA nr.15/2010 pasi që tatimpaguesi nuk ka përcaktim zyrtar nga ATK-ë.

#### Arsyetim

Tatimpaguesi me datë 18.11.2022 ka parashtruar ankesë në ATK-Divizionit të Ankesave i cili konteston mos faljen e ndëshkimeve nga ATK- DMB, që kanë rezultuar si rezultat nga borxhet tatimore për vitet 2015-2021 dhe kërkon që ti falen ndëshkimet pasi ka përmbushur marrëveshjen e pagesë së tatimeve të lidhur në mes ATK-së dhe biznesit në fjalë, i cili pretendon se në bazë të nenit 62 të Ligjit nr.03/L-222 dhe nenin 43 të UA nr.15/2010 i takon kjo e drejtë e zbritjes së ndëshkimeve.

Tatimpaguesi është njoftuar për mes emailit me datë 20.11.2022, e që ky email në aspektin ligjor nuk i plotëson kushtet e aktit administrativ pasi është mangët dhe nuk është lëshuar në mbështetje të neneve: nenit 46, -forma e vendimit, nenit 47- struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit të shkruar dhe nenin 48 –arsyetimi i një akti administrativ me shkrim, të Ligjit nr. 05/L-031 për procedurat e përgjithshme administrative, pra vendimit i mungojnë të gjitha këto elemente.

DA-ja konstaton se ankesa nuk do të shqyrtohet bazuar në nenin 77, paragrafin 2 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, pasi tatimpaguesi nuk ka përcaktim zyrtar nga ATK-ë, dhe i njëjti është dashur fillimisht ti drejtohet ATK-Departamentit për Mbledhjen e Borxheve për lëshim të vendimit konform dispozitave ligjore të cekura më lartë dhe pasi ta pranon përcaktimin zyrtar- vendimin nga ATK-Drejtoria e Mbledhjes së Borxheve, pala ka të drejtë ankesë brenda 30 ndaj çdo vendimi.

Andaj nga e njëjta u konstatua se ankesa sipas ligjit nr:03/L-222,,Për Administratën Tatimore dhe Procedurat", nenin 44, paragrafin 15 të UA nr.15/2010 dhe Nenin 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4, i Ligjit Nr:05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nuk i plotëson kushtet për pranueshme rin e shqyrtimit .  
DA, vlerëson se ankesa e parashtruar është pa përcaktim zyrtar sipas ligjit, pasi që imela nuk mund të konsiderohet akt administrativ dhe e njëjta nuk mund të shqyrtohet pasi tatimpaguesi nuk ka bashkangjitur aktin kontestues me ankesë .  
Nga arsyet e theksuar më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi bazuar në nenin 77.2 të Ligjit nr:03/L-222,,Për Administratën Tatimore Dhe procedurat", nenin 44, paragrafi 15 i UA nr.15/2010 dhe nenin 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4, i Ligjit Nr:05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102"Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-222 "Për Administratën Tatimore dhe Procedurat", tatimpaguesi i pa kënaqur ka të drejtën që brenda afatit tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të Vendimit të Divizionit të Ankesave, ta kundërshtojë këtë vendim tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

**DIVIZIONI I ANKESAVE NË PRISHTINË**  
Nr:483/2021 datë 08.12.2022

Vendimi t'u dorëzohet :

1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore

Udhëheqës i Divizionit të Ankesave  
Skender Krasniqi

Kryesues i rastit  
Ramadan Ahmeti

